

SCC – 08 – 0226

Paditësi

NSH Bletaria “APIKO” Deçan

Përfaqësuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut

I Padituri

Republika e Serbisë

Manastiri i Deçanit

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (“Dhoma e Posaçme”), Kolegji i Specializuar i përbërë nga Esmë Erterzi, gjyqtare kryesuese, Ilmi Bajrami dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 27/12/2012, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Padia refuzohet si e pabazuar.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 prill 2000, Paditësi ka dorëzuar padi në Gjykatën Komunale në Pejë kundër të paditurve: (1) Manastirit të Deçanit, (2) Komunës së Deçanit dhe (3) Republikës së Serbisë lidhur me anulimin e kontratës mbi dhurimin të vitit 1997 për ngastrat kadastrale që kanë qenë në pronësi të NSH “Apiko” kontrata me nr.0464-2914/97, duke kërkuar njohjen e së drejtës së saj pronësore mbi patundshmëritë parcelat kadastrale të evidentuar në fletën poseduese nr. 131 KK Deçan. Paditësi ka pretenduar se kontrata është e pabazuar dhe joligjore dhe si e tillë duhet të anulohet dhe prona duhet t’i kthehet paditësit në posedim dhe pronësi bazuar në dëshminë dhe historiatin e të dhënave kadastrale të lëshuara nga ana e Këshillit Komunal në Deçan – Drejtoratit të Gjeodezisë të datës 30.11.1999.

Është kërkuar nga Gjykata Komunale që të verifikojë se NSH Apiko në Deçan është pronare e pronave të patundshme dhe objekteve tjera në ngastrat kadastrale Nr. 301, 302, 303, 304, 305, 306, 307, 308, 310, 311 dhe 312 në sipërfaqe të përgjithshme prej 12,05.12 ha, e regjistruar në fletën poseduese Nr.131, Komuna e Deçanit. Nga Historiati i Drejtorisë Komunale të Deçanit të vitit 1999, del se ngastrat kadastrale kanë qenë në emër të pronës së shoqërore Organizata Punuese “16 Nëntori Deçan – Stacioni i Apikulturës Deçan”.

Në Gjykatën Komunale në Pejë lënda ka marrë numrin C.nr.23/2000.

Me dt.28.07.2000 Gjykata Komunale në Pejë ka mbajtur shqyrtimin por as i padituri i parë dhe as i tretë nuk janë paraqitur, prandaj, shqyrtimi është shtyrë për datën 28.08.2000. Edhe në këtë

datë të paditurit nuk janë paraqitur dhe seanca dëgjimore është shtyrë për kohë të pacaktuar. Më 28.09.2000 Gjykata Komunale në Pejë shpalli veten jo kompetente dhe lënda është transferuar në Gjykatën Komunale në Deçan.

Gjykata Komunale në Deçan me datë 22.03.2001 bie Aktvendim C.nr.12/2000 duke shpallur veten jo kompetente me të cilin shpallet jo kompetente për këtë çështje juridike dhe pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, lënda duhet të dërgohet në HABITAT (Drejtoria dhe Komisioni për shqyrtimin e kërkesave pronësore dhe banesore) e kompetence të mëtejme.

Paditësi ka parashtruar ankesë kundër këtij aktvendimi Cnr.12/2000 të datës 22.03.2001 dhe Gjykata e Qarkut në Pejë me 04.07.2001 e prishë aktvendimin e Gjykatës Komunale në Deçan dhe e kthen lëndën në procedurë të mëtejme me arsyetimin se Gjykata Komunale ka aplikuar gabimisht dispozitat materiale. Në arsyetimin ligjor thuhet se në Rregulloren 1999/23 dhe 2000/60 e sidomos në bazë të sqarimit të dt.12.04.2001 të lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në rastet siç është rasti konkret, kompetenca e gjykatave të rregullta vendore të Kosovës nuk është e përjashtuar. Lënda konkrete nuk bie në pikat (a), (b) dhe (c) të Rregullores për themelimin e Drejtorisë dhe Komisionit për shqyrtimin e kërkesave të çështjeve pronësore dhe banesore (Habitat)

Pas prishjes së aktvendimit lënda regjistrohet me numrin e ri Cnr.88/2001 në Gjykatën Komunale në Deçan.

Më 23.02.2011 Paditësi parashtrroi një kërkesë për lëshimin e masës së përkohshme që Manastiri i Deçanit ta lejojë kthimin e menjëhershëm në posedim dhe shfrytëzim të lirë të gjithë tokën bujqësore të NSH Bletaria "Apiko".

Komuna e Deçanit më 24.08.2001 e ka ftuar Paditësin që të ndryshojë, korrigjojë dhe sqarojë padinë.

Më 11.09.2011 paditësi parashtrroi padinë e ndryshuar duke kërkuar që të bëhet verifikimi i pronësisë si dhe që të anulohet kontrata Nr.0464-2914/97 e lidhur në mes të Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit si e pabazuar dhe e paligjshme.

Më 28.02.2002 e paditura e dytë Komuna e Deçanit parashtrroi një parashtrësë ku nuk e ka kontestuar padinë e NSH Apiko Deçan dhe i ka propozuar Gjykatës që të aprovojë padinë e paditësit në tërësinë e saj.

Më 19.03.2002 Gjykata Komunale e Deçanit e mbajti seancën e parë dëgjimore në të cilën nuk janë paraqitur as i padituri i parë e as i tretë. I padituri i parë është ftuar në mënyrë të rregullt përmes aktit të Gjykatës të datës 05.03.2002 nëpërmjet policisë së UNMIK-ut por nuk iu është përgjigjur ftesës.

Me datë 19.04.2002 u mbajt seanca dëgjimore dhe sërish seanca u shty për datën 28.06.2002 ngase nuk kishte asnjë përgjigje nga Departamenti i Drejtësisë në Prishtinë për të paditurin e parë dhe të tretë.

Me 28.06.2002 Gjykata Komunale në Deçan mbajti seancën kryesore dëgjimore në të cilën morën pjesë paditësi dhe përfaqësuesi i paditurit të dytë ndërsa e paditura e parë e refuzoi ftesën dhe i padituri i tretë edhe pse e ka marrë ftesën më 29.04.2002 nuk e ka arsyetuar mosardhjen e tij.

Gjykata Komunale, në bazë të nenit 295 të LPK-së mori vendim që sëra dëgjimore të mbahet në mungesë të të paditurve, të cilët janë ftuar në mënyrë të rregullt. Pas leximit të padisë, administrimit të provave dhe fjalës përfundimtare të paditësit Trupi Gjykoës lëshoi Aktgjykimin me të cilin e anuloi kontratën mbi dhurimin nr.0464-2914/97, vërtetoi se NSH Apiko është pronare e paluajtshmërive, parcelave kadastrale të evidentuara në fletën poseduese me Nr.131 KK Deçan dhe detyroi të paditurit që t'ia kthejë në posedim dhe shfrytëzim të lirë paluajtshmërinë. Propozimin për masën e përkohshme e refuzoi.

Gjykata Komunale lëshoi aktgjykimin në mungesë me arsyetimin se gjykata në vazhdimësi për thujt një vit i ka ftuar në mënyrë të rregullt disa herë të paditurit e parë dhe të tretë; i padituri i parë ka refuzuar ftesat ndërsa i padituri i tretë, edhe i ka pranuar ftesat në mënyrë institucionale, nuk e ka arsyetuar mungesën e vetë, dhe në pajtim me dispozitën e nenit 295 të LPK-së lëshoi Aktgjykimin në fjalë.

Gjykata Komunale deklaroi se kontrata e dhurimit është lidhur në vitin 1997 ndërsa Rregullorja Nr.1999/2004 e datës 12.12.1999, e cila ka hyrë në fuqi më 10 qershor 1999, parasheh se ligjet e aplikueshme në Kosovë janë ligjet në fuqi prej datës 22 mars 1989. Gjykata Komunale ka theksuar se paluajtshmëria kontestuese e dhuruar me anë të kësaj kontrate nuk ka qenë asnjëherë pronë e Manastirit të Deçanit, që është e vërtetuar nga historiat, të dhënat kadastrale dhe fleta poseduese kontrata nuk është valide; dhe se është lidhur në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme (Gazeta Zyrtare 28/88). Gjykata ka deklaruar se dhurimi është bërë në kohën e masave të dhunshme. Prandaj Gjykata konstaton se kontrata e lidhur në mes të paditurit të parë, Manastirit të Deçanit dhe të paditurit të tretë, Republikës së Serbisë, është e pavlefshme, nule dhe e kundërligjshme, pasi që i padituri i tretë ia ka dhuruar të paditurit të parë paluajtshmërinë, që nuk i takon atij por që është pronë e NSH-së dhe punëtorëve të saj. Gjykata gjithashtu vëren se i padituri i dytë Komuna e Deçanit nuk e ka kontestuar padinë dhe se e ka pranuar atë.

Më 25.11.2002, avokatët e të paditurit të parë dhe të tretë nëpërmjet Zyrës së UNMIK-ut parashtruan një ankesë kundër këtij aktgjykimi pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë, duke e kundërshtuar atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të nenit 354 paragrafi 2.7 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), në lidhje me mundësinë e pjesëmarrjes ligjore të palëve në seancën dëgjimore, përdorimin e gjuhës së palës në procedurë në pajtim me nenin 354 paragrafi 2 pika 8 i LPK-së. Apellesit pretenduan se aktgjykimi ka shkelur udhëzimin i detyrueshëm të lëshuar më 28.06.2000, me të cilin kryeadministratori Kushner duke iu drejtuar administratorit lokal të UNMIK-ut në Pejë në pikën e fundit të saj thuhet që të gjitha kontestet që kanë të bëjnë me pronësi për toka dhe objekte përcjellëse do të vendos autoriteti i duhur Habitati, cili është nën administrimin e UNMIK-ut.

Më 25.10.2005 Gjykata e Qarkut në Pejë lëshoi një Aktgjykim me të cilin prishi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan Cnr.88/2001 të datës 28.06.2002 dhe çështjen e ktheu në Gjykatën Komunale për rigjykim me arsyetimin se aktgjykimi i atakuar ka shkelur nenin 354 paragrafi 2.8 të LPK-së, që kërkon dërgimin e pa rregullt të shkresave gjyqësore. Gjykata e Qarkut vuri në pah se, gjykata e shkallës së parë, gjatë rigjykimit, duhet të konsiderojë parregullsinë e padisë në aspektin e legjitimitetit të palëve, mundësinë e ndryshimit të padisë në mënyrë që ajo të bëhet e kuptueshme.

Pas prishjes se aktgjykimit lënda morri numër te ri C.nr.326/05.

Me 24.11.2006 Gjykata Komunale në Deçan ka ftuar paditësin që ta precizojë padinë në aspektin e legjitimitetit dhe mundësinë e rregullimit të kompensimit të kërkuar në padi.

Me 8.12.2006 paditësi parashtrroi precizimin e padisë për çështjen e legjitimitetit të palëve dhe thotë se ka legjitimitet të palës në procedurë sepse e njëjta është subjekt i regjistruar në bazë të aplikimit për Regjistrim të Përkohshëm të Biznesit pranë UNMIK-ut dhe e regjistruar me Nr. 80132646, datë 11.07.2000. Me datë 29.08.2008 është mbajtur një seancë tjetër me ç'rast palët në procedurë ishin ftuar nga Gjykata me ftesë.

Me 07.12.2007 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ka bërë kërkesë për tërheqjen e lëndës nga Gjykata Komunale në bazë të nenit 4.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13. Me Aktvendimin e datës 20.6.2008, Dhoma e Posaçme, në lëndën RR-08-0001, e tërhoqi padinë kundër dy të paditurve pranë Gjykatës Komunale ku palët në procedurën në lëndën C.nr. 23/2000-(326/05) janë NSH-ja Apiko Deçan kundër Manastirit të Deçanit, Komunës së Deçanit dhe Republikës së Serbisë. Dhoma e Posaçme e ka tërhequr padinë kundër Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit e jo atë kundër Komunës.

Më 17 nëntor 2008, Dhoma e Posaçme mbajti seancën e parë në këtë Gjykatë në lëndët SCC-08-0226 (padia e Apiko përfaqësuar nga AKM-ja) kundër Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit, SCC-08-0227 (padia e NSH Iliria ndër Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit) dhe SCC-06-0484 (padia e Ali Demëukaj kundër ndër Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit, Komunës së Deçanit, NSH Apiko, Zenun Mecaj dhe AKM) së bashku por pa i bashkuar lëndët për shkak të lidhjes së tyre të ngushtë. Seanca ishte në lidhje me meritat e padive por vetëm për çështjet procedurale dhe regjistrimet e tokave në shënimet kadastrale. Është kundërshtuar përfaqësimi i NSH-së nga AKM-ja dhe është dëgjuar qëndrimi e NSH-së ndryshe nga ai AKM-së. Përfaqësuesi i komunës gjithashtu ka qenë i pranishëm në atë seancë për lëndën nr SCC-08-0227.

Më 24 nëntor 2008 AKM-ja ka parashtruar një parashtrësë duke diskutuar autoritetin përfaqësues të AKM-së ndaj NSH-së dhe qëndrimin e saj ligjor në procedurë si dhe ndryshimet e bëra në shënimet kadastrale gjatë vitit.

Më 1.12.2008, NSH Apiko ka parashtruar parashtrësën vetëm në gjuhën shqipe.

Më 10 mars 2009, Trupi Gjykses i Dhomës së Posaçme vendoi që Zyra Ligjore e UNMIK-ut mbanë qëndrim ligjor në lëndë si përfaqësuese e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe ka të drejtën e vetme për të përfaqësuar interesat e ndërmarrjeve dhe në veçanti në këtë lëndë. Gjithashtu në arsyetimin ligjor përmendet se Dhoma lejon NSH-në që të përfaqësohet nga këshilltarët e saj me përjashtim të rasteve dhe vetëm kur AKM (në këtë rast UNMIK) vendos që të ushtrojë autoritetin e vetë administrativ mbi NSH-në. Aktvendimi është kundërshtuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Në anën tjetër Trupi Gjykses me anë të aktvendimit të vetë të datës 18 maj 2009 e ka ftuar në gjykim AKP-në për çdo interes që mund të ketë në emër të NSH-së paditëse.

Më 12.05.2009 AKM dorëzoi parashtrësë për të dyja lëndët SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227 dhe parashtrroi një kërkesë për seancë dëgjimore. Ajo e informoi gjykatën se e tërheq padinë kundër të paditurit të tretë në lëndën me nr. SCC-08-0227 në mënyrë që të mundësojë ujdinë e mundshme. Thuhet se AKM do të pajtohej për një ujdë të propozuar e cila nuk do të kundërshtonte të drejtat e pronësisë së Manastirit të Deçanit për sa i përket ngastrave kadastrale, të cilat aktualisht ndodhen nën Zonën Speciale që përfshinë Manastirin dhe oshënarinë e saj, sipas Vendimit Ekzekutiv të UNMIK-ut Nr.2005/5 dhe do të hiqte dorë në emër të paditësve në lëndët SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227 dhe në emër të çdo NSH-je tjetër nën administrimin e parashkruar dhe autoritetin e çdo të drejte pronësore që ata mund të kenë për ngastrat e tilla.

Palët ishin ftuar për seancën dëgjimore të mbajtur më 19 maj 2009 për të hulumtuar mundësinë e ujdisë. Një tekst i ujdisë me shkrim që i është prezantuar Gjykatës, bashkangjitur në parashtrësën e Manastirit, datë 15.5.2009 nga Gjykata; megjithatë, nuk mund të specifikohet se nga cila palë është parashtruar. Dëgjimet në lëndët SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227 janë mbajtur së bashku. Përfaqësuesi i AKM-së (Zyra Ligjore e UNMIK-ut) deklaroi që UNMIK-u heq dorë nga padia kundër Republikës së Serbisë dhe Komunës së Deçanit. Ai argumenton se nuk është i nevojshëm pëlqimi i gjykatës për një tërheqje të tillë të drejtave pasi që UNMIK-u jo vetëm që po e tërhiqte padinë por edhe po hiqte dorë nga padia në pajtim me nenin 193 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (4/1977). Përfaqësuesi i Komunës deklaroi se Komuna e pranoi tërheqjen e NSH-së por jo atë të UNMIK-ut. Për më tepër, përfaqësuesi i AKM-së dhe ai i Manastirit kanë shprehur deklaratat e tyre gjatë seancës në lidhje me atë ujdë. Ata nënshkruan procesverbalet e seancave të datave të mëparshme.

Më 10 korrik 2009 AKM-ja parashtrroi një kërkesë pranë Dhomës së Posaçme duke kërkuar lëshimin e procesverbalit të vërtetuar dhe një urdhër për zbatimin e ujdisë të arritur në seancën dëgjimore të mbajtur më 19 maj 2009.

Më 26 tetor 2009 në përgjigjen ndaj urdhrit të Gjykatës, AKM-ja ka përsëritur kërkesën e vet për lëshimin e procesverbalit të vërtetuar të seancën dëgjimore të mbajtur më 19 maj 2009 dhe një kërkesë për të urdhëruar zbatimin e ujdisë.

Më 24 korrik 2010, Kolegji i Apelit lëshoi një Aktvendim në lëndën me numër ASC-09-0025 në ankesën e parashtruar kundër Aktvendimit të Trupit Gjykses të datës 10 mars 2009.

Më 9 shkurt 2011 Trupi Gjykses refuzoi kërkesat e AKM-së të datës 10 korrik 2009 dhe 26 tetor 2009. Një ankesë ishte parashtruar nga AKM-ja kundër këtij Aktvendimi.

Më 27 dhjetor 2011 Kolegji i Apelit lëshoi një Aktvendim në lëndën me nr. ASC-11-0038 duke miratuar Aktvendimin e Trupit Gjykses të datës 9 shkurt 2011; ndërsa në të njëjtën kohë duke deklaruar se Trupi Gjykses do të duhet të caktojë një seancë tjetër dëgjimore për të lejuar palët që të plotësojnë ujdinë e tyre me rregullat procedurale që prej datës 19 maj 2009.

Më 1 janar 2012 hyri në fuqi Ligji i ri Nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Me anë të Vendimit të Presidiumit të Dhomës së Posaçme Nr. 1/2012, datë 2 shkurt 2012, Kolegjet e Specializuara ishin themeluar. Lënda fillimisht i është caktuar Kolegjit 4. Me anë të

Vendimit të Presidiumit Nr. 19/2012,d atë 20 qershor 2012, lënda i është caktuar kolegjit për çështje pronësore.

Kolegji i Specializuar për padi pronësore mbajti një seancë dëgjimore më 16 tetor 2012 në lidhje me kërkesën e UNMIK-ut dhe opinionin e Kolegjit të Apelit. Në bazë të aktvendimeve të Kolegjit të Apelit, palët ishin ftuar për seancë dëgjimore. Palët ishin urdhëruar të dorëzojnë në Gjykatë dokumentet të cilat mungonin në lidhje me përfaqësimin e palëve që kanë arritur ujdinë e pretenduar.

Arsyetimi Ligjor

1. Palët

(a) Padiësi

Padiësi në lëndën në fjalë është Ndërmarrja Shoqërore (NSH) “Apiko”, emri i së cilës është ndryshuar kohë pas kohe. Statusi i saj si ndërmarrje shoqërore nuk është kontestuar nga asnjë palë në procedurë. Nuk ka asnjë padië tjetër apo kundër-padiës pos kësaj NSH-je, edhe pse duket se ekzistojnë shumë aksionarë që kanë shprehur interesin e tyre për procedurën, në kapacitete të ndryshme. Është vetëm një padiës: NSH-ja Apiko (me emra të ndryshëm në kohëra të ndryshme). Përfaqësimi i saj apo qëndrimi ligjor në procedurë në emër të NSH si padiës është plotësisht një çështje tjetër e cila do të diskutohet më poshtë në detaje.

(b) Autoriteti administrativ i Agjencisë për NSH-në padiësë

Siç dihet, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit është themeluar me Rregulloren Nr 2002/12 në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) dhe kompetencës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Që nga data 13 qershor 2012, AKM-ja filloi të ketë autoritetin administrativ mbi ndërmarrjet shoqërore. Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18, parasheh që Agjencia të ketë autoritetin administrues në lidhje me të gjitha ndërmarrjet shoqërore në Kosovë. Për më tepër sipas nenit 6.2 të të njëjtës rregullore, Agjencia ka të drejtën që “të disponojë të ardhurat dhe pasuritë e tjera të ndërmarrjes në pronësi shoqërore”.

Ligji Nr 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), i ndryshuar me Ligjin Nr 04/L-034 gjithashtu e rregullon autoritetin administrues të Agjencisë në të njëjtën mënyrë sikurse ishte parashikuar për AKM-në. Neni 6.1 i Ligjit mbi AKP-në, i jep Agjencisë kompetenca ekskluzive dhe të gjëra administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronat që bien nën sferën e neneve 5.1 dhe 5.2. Një autoritet i tillë do të përfshijë çdo veprim që Agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur, brenda limiteve të burimeve administrative të Agjencisë, në mënyrë që të mundësohet më mirë shitja, likuidimi, transferimi apo disponimi tjetër i ndërmarrjes, asetëve apo interesave shtetërore. Ajo ka të drejtën që të emërojë dhe zëvendësojë kryetarin, drejtorin dhe menaxherët e NSH-së.

Në këtë rast, çështja e cila është tejet kontestuese nuk është nuk është autoriteti administrativ i Agjencisë ndaj ndërmarrjeve shoqërore. Ajo që është debat i nxehtë është kryesisht çështja se “cila Agjenci e ka autoritetin administrativ mbi NSH-në”. A është AKM-ja apo AKP-ja?

Çështja e dytë tejet kontestuese në këtë procedurë është “çfarë nëse administratori i NSH-së ka qëndrim tjetër nga qëndrimi i drejtorëve/menaxherëve të vetë NSH-së. Tani, Kolegji së pari duhet të adresojë çështjen primare (nëse është AKM-ja e themeluar nga UNMIK-u apo AKP-ja e

themeluar nga Kuvendi i Kosovës si pasardhëse e të parës ajo që duhet të administrojë NSH-në) sa i përket të dytës (çka nëse NSH-ja ka qëndrim tjetër nga ai i administratorit të vet).

(c) AKM apo AKP?

Se a është AKM-ja apo AKP-ja që e administron NSH-në është diskutuar për një kohë të gjatë në këtë procedurë. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme është përgjigjur jo një herë por dy herë me Aktvendimet e përmendura më lartë në rrethanat procedurale (*Aktvendimi i datës 24.7.2010, lënda nr ASC-09-0025 dhe Aktvendimi i datës 27 dhjetor 2011, në lëndën nr ASC-11-0038*).

Të gjitha argumentet që rrjedhin nga neni 1.2 i Ligjit, të ndryshuar, mbi AKP-në deklarojnë se AKP-ja është trashëgimtare ligjore e AKM-së janë paraqitur përsëri nga vet NSH-ja dhe nga avokati i Komunës gjatë seancave dëgjimore dhe në parashtrësat me shkrim. Edhe përfaqësuesi i AKP-së e argumentoi çështjen edhe me gojë edhe me shkrim gjatë seancës së mbajtur më 19 maj 2009 dhe në ankesën e parashtruar kundër Aktvendimit të Trupit Gjyqësor të datës 10 mars 2009. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë ka pasur rastin që të shpreh kuptimin e saj në lidhje me këtë përfaqësim me anë të letrës së vetë të datës 14 tetor 2009 dhe ka deklaruar se në pajtim me nenin 67.4 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive (Ligji Nr. 03/L-048, datë 13 qershor 2008) lejon dhe detyron Ministrinë e Drejtësisë që të përfshihet në procedurë. Të gjitha këto argumente kanë qenë në dispozicion në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë të gjyqtarëve të asaj kohe dhe janë vlerësuar në aktvendimet përkatëse për këtë çështje.

Më 10 mars 2009, Trupi Gjyqësor i asaj kohe konstatoi se Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut, duke përfaqësuar AKM-në, ka qëndrim ligjor në këtë lëndë dhe se e ka të drejtën e vetme për të përfaqësuar interesat e ndërmarrjeve në lëndën para Dhomës së Posaçme dhe në veçanti për lëndët ku ky aktvendim është i aplikueshëm. Pasi që AKP parashtrroi ankesë kundër Aktvendimit të Trupit Gjyqësor të datës 10 mars 2009, Kolegji i Apelit e vërtetoi konstatimin e Trupit Gjyqësor (Aktvendimi i datës 24 korrik 2010 në lëndën me Nr. ASC-09-0025).

Në një aktvendim tjetër të Kolegjit të Ankesave, datë 27 dhjetor 2011, lënda me nr. ASC-11-0038, në ankesën kundër Aktvendimit të Trupit Gjyqësor të datës 9 shkurt 2011 në lëndët me nr. SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227, është përsëritur se përfaqësimi i NSH-së nga AKM-ja dhe Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut është përfundimtar dhe si i tillë i detyrueshëm dhe se nuk mund të vihet në pikëpyetje më dhe bile të konsiderohet si *res judicata* nga Kolegji i Apelit. Në kohën e lëshimit të atij Aktvendimi, Ligji i ri mbi AKP-në nr 04/L-034 veçse ishte në fuqi.

Nuk është relevante nëse përbërja aktuale e Kolegjit të Specializuar pajtohet me atë konstatim ose jo. Aktvendimet e formës së prerë janë detyruese jo vetëm për palët, por edhe për ato, veç nëse një ligj i ri e rregullon këtë fushë ndryshe, pas adaptimit të një Aktvendimi të tillë të formës së prerë në një çështje procedurale. Parashikimi dhe parimet e sigurisë ligjore kërkojnë që aktvendimet/aktgjykimet e formës së prerë nuk mund të kundërshtohen më tutje, pa marrë parasysh nëse janë të saktë apo jo, veç nëse ekziston një mjet tjetër juridik i jashtëzakonshëm (që akoma i nënshtrohet afatit kohor specifik). Nuk ka asnjë dëshmi apo njoftim në dosje që tregon se ndonjë palë apo person i tretë që pretendon ndonjë interes në këtë lëndë e ka kundërshtuar kushtetutshmërinë e Aktvendimeve të Kolegjit të Apelit apo që ka aplikuar për mjete juridike të jashtëzakonshme në këtë lëndë.

Për lëndën në fjalë, Kolegji i Apelit, në Aktvendimin e vet të datës 24 korrik 2010, ka vendosur se Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut e cila ka të drejtën e vetme për të përfaqësuar NSH-në në kohën kur Ligji mbi AKP-në dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës kanë qenë në fuqi. Kushtetuta në nenin 143, i është referuar Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të

Kosovës të datës 26 mars 2007. Sipas nenit 143.2 të Kushtetutës, dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës do të kenë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë. Për më tepër, Kushtetuta, ligjet dhe aktet e tjera ligjore të Republikës së Kosovës do të interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë (Neni 143.3 i Kushtetutës).

Është fakt shumë i njohur se Propozimi Gjithëpërfshirës (Plani i Ahtisaarit) i jep Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit autoritetin administrativ për ndërmarrjet shoqërore në Kosovës (Shtojca VII i Propozimit Gjithëpërfshirës, Neni 2). Fakti që sot Kushtetuta nuk i referohet Planit Gjithëpërfshirës apo nuk e mbizotëron Kushtetutën nuk është relevant. Të gjitha parashtrirat e palëve dhe deklaratat e tyre në lidhje me ujdinë dhe parashtrimi i tekstit të ujdisë dhe nënshkrimi i procesverbalit të seancës dëgjimore ku është shprehur ujdia, me përjashtim të dokumentit të fundit, i cili plotëson atë të mëparshmin, janë dorëzuar në një kohë kur një referencë e tillë në Propozimin Gjithëpërfshirës ekzistonte ende në Kushtetutë, si me e larta në hierarkinë e normave.

Kolegji i Specializuar nuk do të merr një qëndrim të ri në lidhje me çështjen por vetëm duke iu referuar përcaktimit paraprak të Kolegjit të Apelit në lidhje me përfaqësimin e NSH paditëse nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut, që është vetëm deklarative por jo themelore

(d) Të paditur(it) e tjerë

Dosja origjinale e parashtruar pranë Gjykatës Komonale është drejtuar kundër Republikës së Serbisë si i paditur i parë dhe Komunës së Deçanit si i paditur i dytë dhe Manastirit të Deçanit si i paditur i tretë. Gjykata Komonale para tërheqjes së padisë kishe vendosur se Komuna ka pranuar padinë dhe tërheqjen e Aktvendimit të Dhomës së Posaçme në lëndën me nr. RR-08-0001, duke iu referuar vetëm dy të paditurve të tjerë të mbetur. NSH tërhoqi padinë dhe UNMIK-u tërhoqi kundër Komunës. Komuna pranoi tërheqjen e padisë së NSH-së kundër tij. Në asnjërin rast komuna nuk ka qenë palë e paditur në tërheqjen e aktvendimit. Kërkesa për intervenim është vërejtur vetëm në lëndën me nr. SCC-08-227, seanca e së cilës dëgjimore është mbajtur më 19 maj 2009 (shiko procesverbalin). Edhe nëse është bërë sipas mënyrës së rregullt (shumica e parashtrësive janë vetëm në gjuhën shqipe) për lëndën në fjalë, Kolegji i Specializuar konstaton se pos paditësit Komuna nuk ka asnjë të drejtë që të intervenojë në lëndë sepse pavarësisht se çfarë lidhesh NSH-ja ka pasur nën ligjet e ish-Jugosllavisë, ato lidhje janë shkëputur me rastin e themelimit të AKM-së, si administratore e NSH-së. Në seancën e mbajtur më 19 maj 2009, Zyra Ligjore e UNMIK-ut shprehimisht ka hequr dorë nga padia e parashtruar kundër Republikës së Serbisë në bazë të Nenit 193 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Plani i atëhershëm, pavarësisht se është thënë se do të shqyrtojë parashtrirat me shkrim si të tilla dhe të mbajë një qëndrim pasi që kërkesa për tërheqje të padisë apo heqje dorë nga padia nuk ka vendosur deri më sot. Kolegji i Specializuar konsideron se deklarata e përfaqësuesit të Zyrës Ligjore të UNMIK-ut nuk ka kërkuar pajtimin e Trupin Gjykses. Tërheqja e padisë shprehimisht është rregulluar në UA të UNMIK-ut 2008/6 dhe tani në nenin 26 të Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, i cili kërkon pëlqimin e Kolegjit të Specializuar. Megjithatë, nuk ekziston ndonjë dispozitë e caktuar mbi heqjen dorë të padisë dhe të drejtave në UA të UNMIK-ut 2008/6 apo në Shtojcën e Ligjit mbi Dhomën e Posaçme. Prandaj, dispozita e Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK i vjetër, Neni 193, LPK i ri, Neni 261) është i aplikueshëm, në pajtim me nenin 70 të UA të UNMIK-ut 2008/6 (dhe neni 14 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme) në lidhje me heqjen dorë të padisë që as nuk ka nevojë për pëlqimin e gjykatës as të të paditurve. Deklarata e bërë nga përfaqësuesi i paditësit më 19 maj 2009, prandaj, ka prodhuar efektin e vetë ligjor në

datën e njëjtë. Tani, kolegji merr në konsideratë faktin se Republika e Serbisë nuk është një palë në këtë procedurë, I padituri i vetëm i mbetur është Manastiri i Deçanit. Konstatime të tilla janë arritur nga Kolegji dhe lajmëruar gjatë seancës dëgjimore të mbajtur më 16 tetor 2012.

2. Kompensimi i kërkuar

Në padinë e parashtruar në Gjykatën Komunale kompensimet e kërkuara nga gjykata lokale të ndryshuara ishin të dy pjeshme:

- (a) kërkesa ku kërkohet verifikimi i të drejtës pronësore mbi pasurinë e patundshme të përshkruar në fletën poseduese nr 131, më vonë e ndryshuar ku kërkohet regjistrimi i tokave në emër të NSH-së si dhe dorëzimi i posedimit dhe
- (b) kërkesa ku kërkohet anulimi i kontratës së dhurimit e datës 5 nëntor 1997 të lidhur në mes të Manastirit të Deçanit dhe Republikës së Serbisë.

Sa i përket kompensimit të parë, Kolegji konstatoi se, pavarësisht nga të gjitha veprimet e marra nga organe të ndryshme në kohëra të ndryshme, tokat në fjalë janë edhe të regjistruara në emër të NSH-së paditëse që nga datat 14 gusht 2012 siç është verifikuar me përgjigjen e Kadastrës në kërkesën e Gjykatës dërguar për një lëndë e cila më parë ishte mbajtur bashkë me këtë lëndë (Lënda Nr. SCC-06-0484). Rrjedhimisht, edhe pse nuk është arritur ujdë në mes të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, paditësit mund t'i mungojë interesi në atë padi të parashtruar në Gjykatën Komunale.

Sa i përket kompensimit të dytë, paditësi nuk është njëra nga palët e një kontrate të tillë të dhurimit të bërë nga Republika e Serbisë dhe Manastiri. Kështu paditësit mund t'i mungojë legjitimiteti aktiv në atë padi përveç nëse njëri nga kontraktuesit bën një veprim për të kërkuar regjistrimin e tokës në emrin tij në bazë të kontratës së dhurimit.

Lidhur me këtë vlen të përmenden Vendimet Ekzekutive të PSSP-së në lidhje me ndryshimet në të dhënat Kadastrale. PSSP-ja, fillimisht me Vendimin Ekzekutiv Nr 2008/16 të datës 22 prill 2008, vendosi që në mungesë të dokumentacionit provues të ofruar nga Komuna e Deçanit, shënimet në ngastrat e tokës nr 301 përmes 312 (fleta poseduese nr 131) aktualisht e regjistruar në librat kadastrale të Komunës së Deçanit në emër të Ndërmarrjes Shoqërore "16 nëntori Qendra e Bletarisë Deçan, ngastrat e tokës nr. 494, 495, 502, 503, 522, 523, 524, 528, 1104, 1105 dhe 1106 (fleta poseduese Nr 237) aktualisht e regjistruar në librat kadastrale të Komunës së Deçanit në emër të Ndërmarrjes Shoqërore "Ndërmarrja Hoteliere Turistike Deçan dhe ngastra e tokës Nr. 943 (fleta poseduese Nr.119) aktualisht e regjistruar në librat kadastrale të Komunës së Deçanit në emër të Ndërmarrjes Shoqërore "Ndërmarrja Publike Banësore" duhet të anulohen përkohësisht me efekt të menjëhershëm dhe të bëhet kthimin në *status quo ante*. Vendimi Ekzekutiv do të rishikohet nëse Komuna e Deçanit ia ofron UNMIK-ut dokumentacionin provues të pranueshëm. Gjithashtu në këtë Vendim Ekzekutiv thuhet se kjo do të jetë pa paragjykim në përcaktimin autoritar përfundimtar të të drejtave pronësore në lidhje me ngastrat e tokave në fjalë pas rezultatit të procedurës gjyqësore në vazhdim para gjykatave kompetente në Kosovë dhe procedurës në vazhdim para Agjencisë Kosovare të Pronës.

Me Vendimin Ekzekutiv Nr 2008/21 pasues, të datës 17 maj 2008, PSSP-ja vendosi që shënimet në Kadastër të anulohet me Vendimin Ekzekutiv Nr 2008/16, duhet të zëvendësohen me shënimet në të dhënat kadastrale që janë kthyer dhe në pajtim me fletën poseduese Nr 138 (N95-01-1/97) lëshuar nga Zyra për Kadastrën e Tokës në Pejë më 10 mars 1998. Më tej theksoi se në pajtim me të mësipërmin manastiri ortodoks serb Visoki Deçani do të vazhdojë të gëzojë

posedimin e papenguar të ngastrave të tokës Nr 301 përmes 312 (fleta poseduese aktuale Nr 131), ngastrat e tokave Nr 494, 495, 502, 503, 522, 523, 524, 528, 1104, 1105 dhe 1106 (fleta poseduese aktuale Nr 237) dhe ngastra e tokës Nr 943 (fleta poseduese aktuale Nr 119). Në rast të gjykimit autoritar të të drejtave pronësore lidhur me tokat në fjalë nga një gjykatë e Kosovës që ka juridiksionin kompetent, pas rezultatit të procedurës në vazhdim para Agjencisë Kosovare të Pronës, të dhënat kadastrale duhet të reflektojnë saktësisht atë gjykim.

Kolegji nuk e din se pse Vendimi Ekzekutiv i UNMIK-ut Nr 2008/21 nuk është ekzekutuar në të dhënat Kadastrale. Ajo çfarë dihet është se të dhënat kadastrale janë ende në emër të NSH-së dhe palët janë në dijeni për këtë fakt pasi që mund të kuptohet lehtë nga parashtresat e tyre verbale gjatë seancave. Kështu, NSH-së duket se i mungon interesi ligjor për të kërkuar verifikimin e të drejtës pronësore dhe regjistrimin e saj në kadastër.

Sa i përket dorëzimit të posedimit të ngastrave kadastrale, posedimi i tokave nga Manastiri i paditur veçse është mbrojtur me Vendimin Ekzekutiv të lartpërmendur të PSSP-së. Që nga sot, pasi që lënda në pritje për t'u zgjidhur pranë Dhomës së Posaçme është në fazën e saj të hershme për sa i përket zhvillimit të procedurës, Kolegji nuk zotëron ndonjë informacion nëse Agjencia Kosovare e Pronës ka bërë një vendim të tillë duke iu referuar Vendimit Ekzekutiv Nr 2008/21 të PSSP-së. As nuk është relevante, pasi që padia e NSH-së paditëse ku kërkon dorëzimin e posedimit si e tillë sot nuk do të binte në juridiksionin e Dhomës së Posaçme e cila vepron sipas Ligjit Nr 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme. Dhoma e Posaçme ka juridiksion mbi paditë kundër NSH-ve apo Agjencisë së paditur, por jo atyre të NSH-së në cilësinë e paditësit kundër personave fizik apo juridik privat. (Neni 4 që lidhet me nenin 5.2.2 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme).

3. Regjistrimi në kadastër dhe gjenda aktuale që nga data e ujdisë

Kolegji i specializuar nuk e din nëse palët janë përpjekur të ndryshojnë të dhënat kadastrale në pajtim me Vendimin Ekzekutiv të UNMIK-ut Nr 2008/21 dhe nëse po, pse ai nuk mund të ekzekutohet. Megjithatë, ajo çfarë është e rëndësishme është se tokat e kontestuara janë ende të regjistruara në emër të paditësit.

4. Ujdia

Duke marrë parasysh përcaktimin e Kolegjit të Apelit se është Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut, si përfaqësuese e AKM-së, e cila e ka të vetmin qëndrim ligjor në procedurë; dhe duke kujtuar se e njëjta erdhi në përfundim se NSH-ja mund të përfaqësojë vetëm vetveten përveç nëse AKM-ja merr përsipër procedurën, siç është diskutuar më lartë në detaje, pretendimi i thjeshtë i NSH-së se nuk pajtohet me ujdinë gjoja të arritur në mes të AKM-së dhe Manastirit të paditur ose se ajo duhet të ishte përfaqësuar nga AKP-ja e jo nga AKM-ka, nuk mund të sjellin ndonjë veçori të re në diskutim. Të gjitha ato argumente veçse janë përgjigjur nga shkalla e parë dhe e dytë.

Pas kësaj pike, ajo çfarë Kolegji i Specializuar duhet të kërkojë është nëse ujdia a arritur në mes të Zyrës Ligjore të UNMIK-ut dhe të vetmit të paditur të mbetur Manastiri i Deçanit i plotëson kërkesat e rregullave procedurale dhe çfarë lloj ndikimi juridik mund të rezultojë nga ajo.

Palët, në veçanti AKM-ja, kanë dorëzuar vazhdimisht në Gjykatë parashtresa me shkrim dhe verbale për qëllimin e AKM-së dhe Manastirit që të arrijnë një ujdë. Në disa prej atyre parashtresave janë shprehur vetëm dëshirat e thjeshta të AKM-së apo gatishmëria e saj për të arrirë ujdë ndërsa në disa parashtresa tjera me shkrim ishte bashkëngjitur përmbajtja e ujdisë. Ajo çfarë është e rëndësishme të përmendet këtu është se Trupi Gjykues dhe Kolegji i Apelit i

Dhomës së Posaçme nuk i kanë konsideruar këto ujdë të shprehura nga AKM-ja dhe Manastiri të jenë në pajtim me rregullat procedurale të aplikueshme. Refuzimi i mëparshëm nga Trupi Gjykses se ujdia ishte arritur nuk ka të bëjë asgjë me përmbajtjen e ujdisë apo autoritetin e palëve që të arrijnë ujdë por thjeshtë sepse Trupi Gjykses i atëhershëm kishte konsideruar se ujdia e pretenduar nuk ishte në pajtim me rregullat procedurale.

Si katër parashtresat e rëndësishme në lidhje me vullnetin për të arritur ujdë, mund të përmenden si vijon;

- (a) Vullneti për të arritur ujdë i shprehur në parashtresën e UNMIK-ut/AKM-së të datës 12 maj 2009 dhe kërkesa për seancë dëgjimore për ta paraqitur këtë ujdë
- (b) Ujdia e shprehur gjatë seancës të mbajtur më 19 maj 2009 dhe
- (c) Kërkesa e bërë më 10 korrik 2009 nga UNMIK-u/AKM-ja ku kërkonin procesverbalin e vërtetuar të seancës dëgjimore të datës 19 maj 2009 dhe ekzekutimi i ujdisë
- (d) Ujdia e paraqitur me shkrim dhe e shprehur në seancën e mbajtur më 16 tetor 2012 dhe e plotësuar në pajtim me mendimin e Kolegjit të Apelit të deklaruar në aktvendimin e tij të lëndës ASC-11-0038 të datës 27 dhjetor 2011

Trupi Gjykses dhe Kolegji i Apelit më parë nuk i kanë konsideruar tri të parat si ujdë të mirëfilltë në pajtim me rregullat procedurale.

Trupi Gjykses me anë të aktvendimit të datës 9 shkurt 2011 ka refuzuar kërkesën e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut të datës 10 korrik 2009 dhe parashtresën tjetër të datës 26 tetor 2010 duke përsëritur të njëjtën kërkesë, ku në të dyja UNMIK-u pretendoi se ujdia e arritur në mes të palëve është përfundimtare dhe detyruese për palët. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që t'i ofrohet kopja e vërtetuar me origjinalin e procesverbalit të seancës dëgjimore të mbajtur më 19 maj 2009 si dhe lëshimi i një urdhri për zbatimin e ujdisë së arritur në mes të palëve të mbetura pas heqjes dorë nga padia kundër të paditurit Republika e Serbisë në pajtim me nenin 193 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Parashtruesi i kërkesës kërkoi kopjen e vërtetuar të procesverbalit të seancës dëgjimore në pajtim me nenin 322 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe që Dhoma e Posaçme të marrë masa të nevojshme, pas lëshimit të asaj kopjeje të vërtetuar për zbatimin e ujdisë të arritur nga palët sipas rregullit gjatë seancës dëgjimore të mbajtur pranë Dhomës së Posaçme duke i urdhëruar autoritetet kompetente që të bëjnë ndryshimet e nevojshme në të dhënat kadastrale.

Cili ishte problemi në interpretimin e Trupit Gjykses të mëparshëm?

Pas këtyre kërkesave, Trupi Gjykses e refuzoi kërkesën e datës 9 shkurt 2011 në bazë të argumenteve se ekzekutimet e ujdive nuk janë në juridiksionin e Dhomës së Posaçmedhe më e rëndësishmja një ujdë nuk ishte finalizuar në mes të palëve. Ai gjithashtu diskutoi se procesverbalit është dëshmi të cilën palët kanë të drejtë ta marrin për të provuar obligimet e tyre të marra në seancën dëgjimore. Kjo nënkupton se Trupi Gjykses madje refuzoi që t'ia ofrojë parashtruesit të kërkesës procesverbalin e vërtetuar. Për më tepër, me sa duket Trupi Gjykses i atëhershëm erdhi në përfundimin se heqja dorë nga ajo e drejtë mund të bëhet vetëm gjatë seancës dëgjimore dhe se nuk ka ndonjë deklaratë të tillë të bërë në mënyrë të mirëfilltë gjatë seancës dëgjimore. Trupi Gjykses pohoi se jashtë Gjykatës, palët ishin të lirë të bëjnë të gjitha deklaratimet lidhur me të drejtat e tyre por pasi që ata kërkuan që marrëveshja e tyre të miratohet nga Gjykata, kufizimet procedurale të gjykimit duhej të verifikoheshin. Trupi Gjykses më tej diskutoi se në lidhje me ngastrat për të cilat AKM-ja heq dorë nga e drejta; nuk është e qartë nëse kjo heqje dorë ishte bërë në favor të AKM-së dhe nëse ajo do të thotë bartje e të drejtës apo njohje e të drejtave të kërkua (për detaje shiko *Aktvendimin*). Kjo është çfarë Kolegji i atëhershëm kishte konsideruar se kontratës

(domethënë marrëveshjes) i mungonte shkaku kryesor i ujdisë që nuk mund të miratohet. Në anën tjetër, Trupi Gjykses argumentoi se nuk është e qartë nëse vullneti i paditësit për të heqë dorë nga paditë kundër tyre të paditurve mbetet i pandryshuar në qoftë se ujdia nuk aprovohet.

Ai Aktvendim i Trupit Gjykses ishte rishikuar nga Kolegji i Apelit. Kolegji i Apelit, sikurse është paraqitur nga ai, kishte rishikuar “Aktvendimin vetëm në përmbajtjen e ankesës”. Ai deklaroi se ai Aktvendim ishte i saktë dhe në pajtim me dispozitat ligjore të çështjes lëndore në fjalë. (*Aktvendimi i datës 27 dhjetor 2011 në lëndën nr ASC-11-0038*).

Cili ishte problemi në interpretimin e Kolegjit të Apelit sa i përket ujdisë së pretenduar?

Me sa duket, arsyetimi i Kolegjit të Apelit ishte, megjithatë, pak më ndryshe nga ai i Trupit Gjykses. Kolegji i Apelit theksoi shpjegimin e Trupit Gjykses mbi procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 19 maj 2009, gjatë të cilës ata i kishin bërë deklaratat e tyre e që këto përbëjnë ujdinë e tyre por procesverbali ishte nënshkruar nga palët në data të ndryshme. Nënshkrimi i përfaqësuesit të paditësit mban datën 22 qershor 2009 ndërsa ai i të paditurit mban datën 8 korrik 2009. Kolegji i Apelit i dha rëndësi këtyre datave të ndryshme të nënshkrimit të procesverbalit. Në interpretimin e Kolegjit të Apelit, për atë që UA-ja e UNMIK-ut Nr 2008/6 në nenin 26.4 kërkon që një marrëveshje e tillë duhet të jetë me shkrim, formulimi i këtij neni nënkupton që një marrëveshje duhet të paraqitet me shkrim nga palët jashtë seancës dëgjimore. Të citojmë nga ai Aktvendim “...pas marrëveshjes me shkrim, të dorëzuar Trupit Gjykses, Gjykata mund të mbyllë lëndën, dhe palët janë të lirë që të japin përmbartimin e marrëveshjes së tyre me instrumentet ligjore të parapara me ligj në këtë shkallë”.

Sipas Kolegjit të Apelit, një formë tjetër e ujdisë brenda Gjykatës është paraparë me nenin 322 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK e mëparshme), i zbatueshëm në procedurën para DHPGJS-së në bazë të nenit 70.3 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6. Neni në fjalë thotë “*Marrëveshja e palëve mbi pajtimin përfshihet në procesverbal. Pajtimi qubet i përfunduar kur palët pas leximit të procesverbalit mbi pajtimin e nënshkruajnë procesverbalin. Palëve, me kërkesën e tyre do t'i jepet kopja e legalizuar e procesverbalit, ku është përfshirë pajtim?*”

Pas dhënies së këtyre shpjegimeve, Kolegji i Apelit erdhi në përfundim se në lëndën në fjalë procedura e paraparë me dispozitën e mësipërme nuk ishte respektuar pasi që palët kanë nënshkruar procesverbalin në data të ndryshme. Sipas Kolegjit të Apelit, neni 322 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, siç mund të kuptohet me një lexim të plotë të ligjit, nënkupton që marrëveshja duhet të bëhet në të njëjtën kohë nga palët, gjatë të njëjtës seancë dëgjimore, të cilët e nënshkruajnë marrëveshjen para gjyqtarit përgjegjës në seancën dëgjimore publike, “pasi tu lexohet procesverbali”.

Megjithatë, ai deklaroi se Trupi Gjykses duhet të kishte caktuar një seancë tjetër dëgjimore, gjatë të cilës palët do të kishin finalizuar procedurën e ujdisë sipas nenit 26.4 të UA-së së UNMIK-ut Nr 2008/6, ata do të mund të kishin arritur marrëveshje jashtë seancës dëgjimore, ta kishin paraqitur në një formë të shkruar, dhe pastaj t’ia paraqitnin atë DHPGJS-së.

Kolegji i Apelit ka heshtur sa i përket mos-lëshimit të procesverbalit tek palët siç është kërkuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut.

Kolegji i Apelit vërejti se palët kishin shprehur vullnetin e tyre për të zgjidhur kontestin dhe prandaj, Trupi Gjykses duhet të caktojë një seancë dëgjimore për të hetuar mundësinë e arritjes së një zgjidhjeje të tillë në bazë të dispozitave të zbatueshme.

Një tjetër pikë e ngritur nga Kolegji i Apelit ishte se sido që të jetë përmbartimi i kësaj ujdje nuk bie në juridiksionin e Dhomës së Posaçme.

Më 20 qershor 2012, lënda u transferuar në juridiksionin dhe kompetencën e Kolegjit për Çështje Pronësore, si rezultat i Vendimit të Presidiumit Nr 19/2012. Kolegji për çështje pronësore, në bazë të kërkesës së Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut dhe duke marrë parasysh Aktvendimin e Kolegjit të Apelit caktoi një seancë tjetër dëgjimore. Seanca dëgjimore u mbajt më 16 tetor 2012.

Përfaqësuesi i paditësit, në seancën e mbajtur më 16 tetor 2012, e paraqiti me shkrim tekstin e ujdisë së arritur në mes të Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut dhe Manastirit të Deçanit dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e atyre palëve dhe konfirmoi gjatë seancës, pas leximit të tekstit. Për shkak se procesverbal i redaktuar u bë i disponueshëm për rishikim të Gjyqtarës Kryesuese pas disa ditësh nga procesmbajtësi dhe pastaj ai ka nevojë të përkthehet në gjuhën e palëve para se të nënshkruhet, nuk ishte e mundur që procesverbal të nënshkruhej në datën e seancës dëgjimore. Por, procesverbal i nënshkruar nga Gjyqtarja Kryesuese iu dërgua të dyja palëve që arritën ujdinë dhe ata u ftuan të nënshkruajnë procesverbalin në të njëjtën datë. Ata e nënshkruan procesverbalin e seancës në të njëjtën kohë më 15 nëntor 2012. Kështu, kërkesat procedurale të nenit 26.4 dhe nenit 322 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (4/1977) dhe nenit 26 të Shtojcës si the nenit 416 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr 03/L-006) u plotësuan të gjitha.

Të vetmet dokumente që mungojnë janë ato që tregojnë personalitetin ligjor të Manastirit në vetvete pavarësisht nga ndonjë institucion tjetër në Serbi apo Kosovë, përfaqësimin e Manastirit dhe të drejtën për të arritur ujdin si entitet i veçantë juridik dhe dokumentet që tregojnë emërimin e Kryemurgut të Manastirit. Dokumentet e tilla si dhe përkthimi i ujdisë në gjuhën serbe janë paraqitur nga palët brenda afatit të caktuar nga Gjyqtarja Kryesuese gjatë asaj seance dëgjimore.

Përfaqësuesi i NSH-së e kundërshtoi ujdinë e arritur nga UNMIK-u dhe Manastiri i Deçanit. Ai argumentoi se AKP-ja duhet të ishte ftuar në seancën dëgjimore. Gjatë seancës u shpjegua se palët ishin ftuar në seancën dëgjimore duke marrë parasysh Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të datës 24 korrik 2010 në lëndën nr ASC-09-0025.

Sa i përket rregullave procedurale, paraqitja e ujdisë mu tani, madje edhe ajo e shprehur në seancën dëgjimore të datës 19 maj 2009 ishte e kompletuar në interpretimin e Kolegjit të tanishëm të Specializuar për Çështje Pronësore. Para asaj seance, UNMIK veçse kishte ofruar një tekst për të treguar vullnetin e vet. Në seancë e përsëriti propozimin. Propozimi si i tillë u pranua nga përfaqësuesi i Manastirit. Gjyqtarja Kryesuese deklaroi se Gjykata do të preferonte të ketë një tekst me shkrim dhe iu dha kohë atyre që të jenë të qartë në përmbajtjen e ujdisë. Megjithatë, përfaqësuesi i Manastirit deklaroi qartë se atyre nuk iu duhet kohë për këtë dhe e pranuan ofertën e bërë nga përfaqësuesi i Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut. Në interpretimin e Kolegjit të Specializuar, oferta dhe pranimi i ofertës është i mjaftueshëm që të vendoset se është arritur marrëveshje. Ky është parimi themelor i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (apo Kontratave) në shumë sisteme ligjore se si të arrihet një marrëveshje. Se a është e nevojshme një formë e shkruar për vlefshmërinë e një marrëveshjeje të tillë është një çështje tjetër. Nganjëherë, forma e shkruar mund të jetë e detyrueshme për vlefshmërinë e një marrëveshjeje ndërsa për disa lloje të kontratave mund të mos jetë një element themelor por vetëm deklarues apo vetëm çështje e vërtetimit të ekzistimit të një marrëveshjeje të tillë. Sido që të jetë, vullneti i lirë i palëve ishte paraqitur në procesverbalin e datës 19 maj 2009 dhe ai procesverbal ishte nënshkruar nga ata edhe pse nënshkrimi i procesverbalit nga palët ishte bërë në tjetër kohë. Megjithatë, Kolegji siç u përmend më lartë e konsideron se ai kufizohet me interpretimin e Kolegjit të Apelit në atë se si të arrihet ujdin.

Neni 416 i LPK-së (Ligji Nr 03/L-006) e rregullon formën e ujdisë dhe përcakton mënyrën e arritjes së saj. Sipas këtij neni, ujdia përfshihet në procesverbalin e takimit. Pajtimi gjyqësor është i përfunduar në momentin kur palët e lexojnë procesverbalin e takimit mbi pajtimin dhe e nënshkruajnë atë. Kopja e vërtetuar e procesverbalit të takimit, duke përfshirë ujdinë, u jepet palëve. Pajtimi gjyqësor duhet të përmbajë edhe marrëveshjen mbi shpenzimet gjyqësore. Po që se palët nuk merren vesh rreth shpenzimeve, ato mund të kërkojnë që vendimin mbi shpenzimet gjyqësore ta jep gjykata e çështjes.

Ajo ujdi e paraqitur në seancën e mbajtur më 16 tetor 2012 konsiderohet të jetë në pajtim me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit. Konsiderohet se teksti i përfunduar dhe i nënshkruar jashtë gjykatës dhe i paraqitur dhe i lexuar dhe konfirmuar gjatë seancës dëgjimore nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut si paditës që ka qëndrim ligjor në procedurën lidhur me padinë e parashtruar nga NSH-ja (në pajtim me nenin 29.2 dhe 3 të RREG UNMIK-ut 2002/12, të ndryshuar, dhe nenin 29.2 dhe 29.3 të Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme) dhe të vetmit të paditur të mbetur Manastiri i Deçanit është në pajtim me nenin 26 të UA-së së UNMIK-ut Nr 2008/6 dhe atë të Shtojcës së LDHP-së dhe se ajo ujdi është përfunduar dhe është në pajtim edhe me nenin 416 të LPK-së.

5. Mungesa e kundërpadisë

Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut ka kërkuar lëshimin e një urdhri për ndryshimin në librat e Kadastrës për të reflektuar ujdinë në të dhënat kadastrale. Megjithatë, deri më tani nuk ka asnjë kundërpadi apo padi të veçantë të parashtruar nga i padituri Manastiri i Deçanit për verifikimin e të drejtave pronësore mbi tokën në fjalë dhe/apo regjistrimin e tyre në regjistrat e Kadastrës në emrin e tij

Ujdia dhe efekti detyrues i saj e arritur nga palët në një procedurë në pritje për t'u zgjidhur është një koncept tjetër ligjor e jo një pranim i padisë apo kundërpadisë. Pa pasur kundërpadi, Gjykata mund të vendosë vetëm në efektin e ujdisë mbi kompensimin e kërkuar në një procedurë në pritje për tu zgjidhur në bazë të një padie.

Çfarë mund të vendosë Kolegji i Specializuar kufizohet në padinë e NSH-së. Ajo ose mund të miratojë kompensimin e kërkuar me të apo t'a refuzojë. Duke marrë parasysh se i padituri nuk ka parashtruar kundërpadi e cila do t'i nënshtrohej disa afateve që tanimë kanë skaduar, Kolegji mund të marrë qëndrim vetëm për kërkesën e paditësit në procedurën aktuale. Pajtimi gjyqësor mund të arrihet vetëm nëse ngrehet padi (neni 418.1 i LDHP-së).

6. Kompensimi që mund të miratohet në bazë të ujdisë

I vetmi kompensim që mund të miratohet në bazë të kësaj ujdie në ëndën në fjalë është të refuzohet padia. Neni 26 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 apo Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme nuk e shpreh në mënyrë eksplicite se çfarë lloj veprimesh duhet të merren nga Kolegji në bazë të një ujdie. Kjo dispozitë vetëm e përcakton se një ujdi e tillë është detyruese për palët dhe asgjë tjetër. Këtë çështje e mbulon Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

Në bazë të nenit 471 të LDHP-së, gjatë gjithë procesit gjyqësor gjykata konsideron nëse ai është duke u zhvilluar me padinë nëse është bërë ujdia, dhe nëse konsideron se padia është adresuar e refuzon padinë. Pra, i vetmi përcaktim që mund të bëhet tani nga Gjykata për sa i përket ujdisë është të refuzohet padia si e pabazuar.

Pjesa tjetër nuk është në kompetencë të Kolegjit të Specializuar. As nuk ka kundërpadi apo padi të veçantë për t'u bashkuar me këtë të parashtruar nga i padituri për të fituar të drejtën e pronësisë mbi tokat në fjalë apo ku kërkohet verifikimi i pronësisë apo regjistrimi i tyre në emrin e tij.

7. Ekzekutimi i ujdisë

Përfaqësuesi i Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut dorëzoi parashtrësë më 19 nëntor 2012 ku kërkoi kopjen e vërtetuar të procesverbalit të seancës së mbajtur më 16 tetor 2012 si dhe lëshimin e një urdhri për Kadastrën duke e udhëzuar atë që të regjistrojë ngastrat kadastrale në kontest në emër të manastirit të paditur. Procesverbali i seancës dëgjimore në fjalë do t'u ofrohet palëve dhe dërgohet atyre bashkëngjitur me këtë aktgjykim.

Për sa i përket lëshimit të urdhri për ndryshime në Kadastër për të mundësuar ekzekutimin e ujdisë së tyre të arritur në mes të UNMIK-ut dhe Manastirit:

Sipas nenit 414 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr 03/L-006);

Me anë të pajtimit gjyqësor mund të përfshihet e gjithë kërkesëpadija apo vetëm një pjesë e saj. Gjykata me anë të aktvendimit e miraton pajtimin gjyqësor. Megjithatë, palët nuk mund të arrijnë pajtim përmes gjykatës nëse padija ka të bëjë me të drejtat e tyre të cilat ata nuk i disponojnë lirisht (neni 3, paragrafi 3 i LDHP-së). Në një situatë të tillë, palët arrijnë në një marrëveshje mbi të drejtat të cilat ata nuk i disponojnë lirisht, gjykata do të përfshijë në procesverbalin e seancës dëgjimore marrëveshjen në mes të palëve e cila më vonë mund të vlerësohet nga gjykata e apelit për vlefshmërinë e saj (neni 414.4 i LDHP-së). Kështu, ujdia e arritur nga palët mund t'i nënshtrohet ankesës dhe palët e treta mund ende të kërkojnë se të drejtat nuk janë ato që palët i disponojnë lirshëm.

Përndryshe, një ujdi e tillë është detyruese për palët në pajtim me nenin 26 të Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, dispozitë e hollësishme e cila nuk kërkon zbatimin e LDHP-së, ose në këtë kuptim në lidhje me nenin 14 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe/ose nenin 70.3 të UA-së s UNMIK-ut Nr 2008/6.

Megjithatë, ekzekutimi i një ujdie të tillë nuk bie në juridiksionin e Dhomës së Posaçme. Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion mbi ekzekutimin e as madje të vendimeve apo aktgjykimeve të veta. Gjykatat e rregullta kanë juridiksion mbi kërkesat e ekzekutimit. Natyra detyruese e ujdisë në mes të palëve nuk e ndryshon këtë fakt.

Nëse palët dëshirojnë të ekzekutojnë ujdinë e tyre, ata janë të lirë të marrin veprimet e nevojshme para autoriteteve administrative duke paraqitur procesverbalin e nënshkruar nga ata në ujdinë e arritur para Dhomës së Posaçme në këtë lëndë dhe të vërtetuar dhe dërguar atyre nga Gjykata bashkë me këtë Aktgjykim. Në rast të mospajtimit të autoriteteve administrative në ujdinë e tyre, ata mund të paraqesin kundërshtimet e tyre në kuadër të procedurës administrative.

Apo ndryshe, ata mund të kërkojnë ekzekutimin e këtij aktgjykimi para gjykatës së rregullt kompetente nëse dhe kur ai të bëhet i formës së prerë. Vlen të thuhet se një kërkesë e tillë për ekzekutim ende do të bie jashtë juridiksionit të Dhomës së Posaçme.

Shpenzimet

Palët nuk kanë marrë qëndrim për sa i përket shpenzimeve. Kështu, asnjëra palë nuk kërkon kompensim në të holla. Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore, Kolegji vendosi se nuk nevojitet

ngarkimi i shpenzimeve pasi që ende nuk ka një plan me shkrim të gjykatës që është aprovuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me nenin 57.2 të Shtojcës të LDHP-së.

Këshilla ligjore

Ujdia e arritur nga palët është detyruese për ta në pajtim me nenin 26 të Shtojcës së LDHP-së. Një ujdë e tillë mund të kundërshtohet nga ata vetëm në kushtet e përcaktuara në nenin 418.2 të LPK-së.

Në qoftë se ndonjë person tjetër që pretendon se të drejtat e tij/saj procedurale janë cenuar ose ai/ajo ka të drejta themelore mbi çështjen e kësaj lënde ose synon të kundërshtojë ujdinë e arritur; Kolegji kujton se procedura ankimore është si vijon:

Në bazë të nenit 10.6 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, ankesa kundër këtij aktgjykimin mund të parashtrohet me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit brenda njëzetënjë (21) ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi apo dijenia për të. Në bazë të të njëjtit nen ankesa duhet t'u dërgohet palëve tjera brenda të njëjtit afat nga ankuesi dhe prova e dërgimit t'i bashkëngjitet ankesës. Kolegji i Specializuar, në lidhje me këtë, ua kujton edhe dispozitën e nenit 59 të Shtojcës. Kolegji i Apelit mund t'a refuzojë ankesën, kështu ky Aktgjykim do të bëhet i formës së prerë, nëse palët nuk e përmbushin dispozitën e nenit 10.6 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe nenit 59 të Shtojcës brenda afatit të paraparë.

Se a është e pranueshme ankesa e atyre që pretendojnë interesa të tilla apo jo kjo do të vlerësohet nga Kolegji i Apelit.

Esmë Erterzi,

Gjyqtare Kryesuese, EULEX